Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1010
Data e Vendimit: 26.12.2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik "SELMANS NETWORK" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i hapësirave të brendshme të Spitalit" me numër të prokurimit 70020-23-11204-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "SPITALI I PËRGJITHSHEM - GJAKOVË", Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me 26/12/2023, mori këtë:

Vendim

Hedhet si e palejuar ankesa e OE "SELMANS NETWORK" SH.P.K me nr. të protokollit 2023/1010, e datës 13/12/2023, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i hapësirave të brendshme të Spitalit", me numër të prokurimit 70020-23-11204-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "SPITALI I PËRGJITHSHEM - GJAKOVË".

I lejohet "SPITALI I PËRGJITHSHEM - GJAKOVË" nga cilësia e saj si autoritetit kontraktues që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i hapësirave të brendshme të Spitalit" , me numër të prokurimit 207-23-12967-5-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 13.12.2023 ka pranuar ankesën me nr.1010/23 nga "SELMANS NETWORK" SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Pastrimi i hapësirave të brendshme të Spitalit" me numër të prokurimit 70020-23-11204-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "SPITALI I PËRGJITHSHEM - GJAKOVË"

Me datë 18.10.2023 "SPITALI I PËRGJITHSHEM - GJAKOVË" ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e AK.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i hapësirave të brendshme të Spitalit" me numër të prokurimit 70020-23-11204-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "SPITALI I PËRGJITHSHEM - GJAKOVË" ndërsa me datë 18.10.2023 ka publikuar B05 Njoftimin mbi vendimin e AK. OE ankues "SELMANS NETWORK" SH.P.K nuk ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, ne sistemin e- prokurimi.

OSHP sqaron se OE Ankues ka qenë i obliguar që në pajtim me nenin 108/A të LPP-së pas pranimit të vendimit nga ana e Autoritetit Kontraktues, brenda afateve ligjore të parashtrojnë kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Neni 108/A paragrafi 1 i LPP-së përcakton se*: "Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit. "*Ndërsa neni 109 i LPP-së përcakton se*: "Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji* lidhur me nenit 59 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, andaj si e tillë hedhet si e pa lejuar sepse e njëjta nuk është parashtruar sipas nenit 108/A lidhur me nenin 109 të LPP-së.

SPITALI I PËRGJITHSHEM-GJAKOVË, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit në fazën e rivlerësimit për aktivitetin "Pastrimi i hapësirave të brendshme të Spitalit" me numër të prokurimit 70020-23-11204-2-1-1, megjithatë OSHP i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK ,duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 24.2, 27, 28, 59, 60 dhe 65 të LPP-së.

Zyra për pranim të ankesave ka konstatuar po ashtu se OE Ankues nuk e ka kryer pagesën siç parashihet ne paragrafin 2 të nenit 69 të rregullores 001/2022 të Prokurimit Publik, Me 13.12.2023, OSHP ka kërkuar përmes emailit nga ankuesi që i njëjti të dërgoj dëshmi të fletëpagesës bankare të paguar dhe konfirmuar nga banka, mirëpo Oe ankues nuk ka kthyer përgjigjen. Bazuar në nenit 69.2 dhe në përputhje me nenin 118 të LPP-se, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarife të ankesave në OSHP.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vjosa Gradinaj
Kryetare e OSHP-së

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **SPITALI I PËRGJITHSHEM - GJAKOVË**
- OE - **SELMANS NETWORK SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: